



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA QENDRORE

**OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR SHPALL THIRRJEN PËR
KONKURRIM PËR PROFESIONISTË TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 204, datë 09.04.2024 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike “Infermier për Shqipërinë”, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor shpall thirrjen për konkurrim për profesionistët e shkencave mjekësore teknike për profilet Infermieri, Mami, Teknik Imazherie, Teknik Laboratori, Fizioterapi dhe Logopedi për institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë.

Procesi i konkurrimit për profesionistët e shkencave mjekësore teknike, zhvillohet për:

- të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për ushtrimin e profesionit.
- kandidatët që kanë marrë pjesë në testimin me shkrim “Infermier për Shqipërinë” të thirrjes paraardhëse dhe që dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e tyre. Në fund të konkurrimit, kandidatëve do t’iu njihen pikët e procesit të fundit.
- kandidatët, të cilët kanë qenë pjesëmarrës në procedurën e mëparshme të pranimit dhe kanë dokumentacion shtesë, e depozitojnë atë pranë Sekretariatit Teknik. Komisioni i Vlerësimit mban procesverbal dhe shton pikët e kandidatit.

Aplikimi dhe regjistrimi i kandidatëve do të kryhet vetëm nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”.

Afati për aplikim është nga data 10.08.2026 deri më datë 24.08.2026, përfshirë të dyja këto data.

Kandidatët kanë të drejtë, që në një thirrje për aplikim, të konkurrojnë vetëm për një rajon, brenda të cilit do të mund të përzgjedhin deri në tri njësi vendore të kujdesit shëndetësor.

Dokumentat e domosdoshëm për aplikim për profesionistët e shkencave mjekësore teknike:

- a) jetëshkrimi i kandidatit (CV) (shtojca nr. 1, bashkëlidhur këtij Njoftimi).
- b) fotokopje e letërnjoftimit (ID) – kriter i detyrueshëm për kualifikim.
- c) fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë dhe gjeneralitetet e kandidatit).

d) diplomën universitare dhe listën e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (kriter i detyrueshëm për kualifikim).

e) lejen e ushtrimit të profesionit brenda afatit të vlefshmërisë (kriter i detyrueshëm për kualifikim).

f) deklaratë për vërtetësinë e dokumentacionit të ngarkuar on-line (shtojca nr. 2, bashkëlidhur këtij Njoftimi).

g) dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor).

h) dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja.

Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme si më sipër, skualifikohet.

Regjistrimi i kandidatëve bëhet vetëm nëpërmjet portalit “Infermier për Shqipërinë”.

Vlerësimi paraprak i kandidatëve do të publikohet më datë 15.09.2026. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës.

Kandidatët, njoftohen nga Sekretariati Teknik i platformës “Infermier për Shqipërinë” në të njëjtën ditë që do të publikohet vlerësimi paraprak në portalin “Infermier për Shqipërinë”. Njoftimi bëhet nëpërmjet postës elektronike si për kandidatët e kualifikuar ashtu edhe ata të cilët nuk janë kualifikuar, duke arsyetuar shkaqet e skualifikimit.

Kandidatët kanë të drejtën e ankimit të vlerësimit brenda 48 orëve që nga marrja e njoftimit me email, në ndërfaqen “Ankesa Imë” të platformës elektronike ose në adresën elektronike zyrtare nëpërmjet së cilës janë bërë me dije për vlerësimin apo moskualifikimin dhe/ose me shkresë drejtuar DROSHKSH-së përkatëse. **Afati i fundit për paraqitjen e ankesave është 17.09.2026.**

Komisionet e Vlerësimit të shqyrtojnë ankesat brenda 72 orëve nga përfundimi i afatit të ankimimit. Pas shqyrtimit të tyre, në datën 21.09.2026, Sekretariatet Teknike të pasqyrojnë ndryshimet përkatëse në listën e kandidatëve të kualifikuar dhe të njoftojnë kandidatët, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 204, datë 09.04.2024.

Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve për Fazën e parë do të publikohet më datë 22.09.2026. Në të pasqyrohen ndryshimet pas përfundimit të afatit të ankimimeve dhe shqyrtimit të tyre. Kandidatët, të cilët kanë pësuar ndryshime në vlerësimin e tyre, do të njoftohen nga Sekretariati Teknik përkatës nëpërmjet postës elektronike të vendosur në aplikimin e tyre.

Vlerësimi i kandidatit

Faza I: Vlerësimi i dosjes së kandidatëve: konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **30 pikë**. Kriteret e vlerësimit dhe shkalla e vlerësimit të kualifikimeve nga dosja e kandidatëve përcaktohen sipas Shtojca Nr. 3, bashkëlidhur këtij Njoftimi.

Faza II: Testimi i informatizuar: marrin pjesë kandidatët që kanë kaluar me sukses fazën e parë të vlerësimit me dosje si dhe kandidatë që janë në listë pritjeje dhe dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e testimit të mëparshëm, duke u regjistruar pranë drejtorisë rajonale përkatëse. Testimi i informatizuar vlerësohet deri në **70 pikë**.

Qendra e Shërbimeve Arsimore, është institucioni përgjegjës për zhvillimin e Fazës së dytë, Testimi i Informatizuar, në ambientet e saj (Qendra e Shërbimeve Arsimore me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë, ish-ATSH).

Ditën e testimit, kandidati duhet të jetë i pajisur me:

1. Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti original).
2. Kopje të Kartës ID ose Pasaportës.
3. Faturën me pagesën e tarifës për QSHA-në.

Fusha kryesore e testimit të njohurive:

- Kodi Etik-Deontologjik.
- Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9718, datë 19.4.2007 “Për Urdhërin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”.
- Pyetje të hartuara që lidhen me formimin profesional në bazë profili, sipas një metodologjie nga Udhëzimi Nr. 204, datë 09.04.2024.

Kalendari i testimit (i përgatitur nga QSHA) publikohet dhe në portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit si dhe afateve për shqyrtimin e ankimeve (Faza I dhe Faza II) publikohet në portalin “Infermier për Shqipërinë” lista e kandidatëve që kanë përfunduar me sukses procesin e konkurrimit. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës.

Kandidati konsiderohet fitues nëse ka marrë mbi 40 pikë në total dhe bëhet pjesë e listëpritjes së profesionistëve të shkencave mjekësore teknike të njësive vendore të kujdesit shëndetësor të rajonit në të cilin ka aplikuar.

Në vijim, lista e institucioneve shëndetësore të grupuara sipas njësive vendore të kujdesit shëndetësor të çdo rajon.

CURRICULUM VITAE

Emri, Mbiemri Datëlindja:

dd/mm/yyyy Telefoni:

Adresa: *Email-i:*

Arsimi:

Leja e ushtrimit të profesionit _____, (nr... data e lëshimit):

Kualifikimi Shkencor

Punësimi: vitet dhe institucioni

Publikimet në fushën e shëndetësisë dhe fakti nëse është autor i parë ose bashkautor

Gjuhë të huaja: niveli/nota dhe institucioni që e ka lëshuar

**DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË
DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI**

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për profilin _____
_____, të zhvilluar në _____, më datë _____,
autorizoj _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga
ana ime.

AUTORIZUESI

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR
USHTRIMIN E PROFESIONEVE TË SHKENCAVE TEKNIKE MJEKËSORE

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1.	Përvoja në punë si profesionist i shkencave mjekësore teknike (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune)	1–10 pikë
2.	Studentëve ekselent të tri viteve të fundit u shtohen 5 pikë shtesë (pa tejkaluar 30 pikë gjithsej për vlerësimin e dosjes)	5 pikë
3.	Nota mesatare e studimeve të larta (shprehur në numër dhe një shifër pas presjes dhjetore) Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00–5.50 = 1 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 5.51–6.00 = 2 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01–6.50 = 3 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 6.51–7.00 = 4 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01–7.50 = 5 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 7.51–8.00 = 6 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01–8.50 = 7 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 8.51–9.00 = 8 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01–9.50 = 9 pikë; Nota mesatare (e thjeshtë) 9.51–10.00 = 10 pikë.	1–10 pikë
4.	Shkallët e kualifikimit në fushën e shëndetësisë: Studime të nivelit “Master profesional” – 5 pikë; Studime të nivelit “Master shkencor” (të barasvlershëm) – 8 pikë.	0–8 pikë
5.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL- të publike = 1 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Pavarësisht se kandidatët mund të kenë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.	0–2 pikë